



**Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRY SHE**

Njoftim nga takimi i kryetarit me drejtorët e komunës

Komuna e Prizrenit ndanë 40 mijë euro për transportin e nxënësve udhëtarë

13 gusht 2013, Prizren

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Transparenca online e Komunës së Prizrenit" gjatë kësaj jave ka marrë pjesë në mbledhjen e radhës të kryetarit të komunës, Ramadan Muja me drejtorët komunal, ku janë miratuar disa konkluzione.

Ekzekutivi lokal me kërkesën e Drejtorisë së Arsimit ka nxjerrë konkluzionin për lejimin e shpalljes së tenderit për mbulimin e udhëtimit të nxënësve udhëtarë. Me këtë vendim DKA synon të mbulojë udhëtimin e 25 nxënësve nga SHFMU "Meto Bajraktari" në Reçanë dhe nga fshati Llokvicë gjerë në shkollë dhe anasjelltas, sikurse 7 nxënësve nga Gornje Sello dhe 2 nga fshati Mushnikovë. Po ashtu nga fshati Gorozhupë për në SHFMU "Vëllezërit Frashëri" në Planejë do të përfitojnë gjithsejtë 36 nxënës derisa 26 nxënës do të udhëtojnë nga fshati Tupec dhe Landovicë për në SHFMU "Zenun Çoçaj" në Gjonaj. Paralogaria e projektit kap shumën prej 40 mijë eurove.

Ekzekutivi lokal ka miratuar edhe kërkesat e Drejtorisë për Shërbime Publike për shpalljen e disa tenderëve. Projekti me vlerën më të madhe është ai i "Rivitalizimit të Sheshit të Lidhjes së Prizrenit", e cila shtrihet në zonën historike të qytetit dhe do të realizohet në bashkëpunim me UN-Habitat-in si dhe një pjesë të financimit do ta mbulojë edhe MMPH-ja me ndërtimin e murit përgjatë sheshit. Vlera totale e këtij projekti është 644 mijë e 104 euro.

Është lejuar shpallja e tenderëve për ndërtimin e kanalizimit dhe shtruarjen me elemente betoni të rrugës "Skender Rexhepi" me participim, pastaj ndërtimi i rrugës në lagjen Boqaj, fshati Grazhdanik, ndërtimin e kanalizimit në rrugën "Beteja e Pashtrikut", ndërtimin e rrugës "Besim Shala 1" në Prizren, rruga lokale në fshatin Muradem si dhe ndërtimi i rrugëve me elemente betoni në lagjen e UÇK-së me participim.

Me kërkesën e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport është bërë lejimi i mjeteve për organizimin e manifestimit "Ditët e Mërgatës" që do të mbahet me 15 gusht dhe manifestimit "Epopeja e Vërrinit" me 1 dhe 2 shtator. Drejtorisë në fjalë i është aprovuar edhe kërkesa për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e Bibliotekës Regjionale në Prizren.

Drejtorisë për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik, i është lejuar shpallja e tenderit për organizimin e panairëve. Po ashtu është marrë konkluzioni në lidhje me ndërtimin e objekteve çlodhëse, rekreativo-sportive, në shtëpinë e Bjeshkatarëve afër fshatit Struzhë.

Drejtorisë së Administratës i është dhënë drita e gjelbërt për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me material shpenzues-tonera për nevojat e Komunës, në vlerë prej 40 mijë eurove.

Me kërkesën e Drejtorisë së Shëndetësisë është nxjerrë konkluzioni për shpalljen e tenderit për lyerjen e brendshme dhe të jashtme të Objekteve Shëndetësore dhe vendimi për mbështetjen materiale të disa pacientëve me sëmundje të rënda

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit dhe të Mamushës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. "Saraqët" Nr.5 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit dhe Mamushës" prej muajit maj 2013 përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.